

## **Njoftim për shtyp, datë 9 Tetor 2020**

Sot me datë 09.10.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi mbledhjen plenare të radhës, në të cilën pas shqyrtimit të kriterëve ligjore të emërimit, pasurisë dhe figurës vendosi kualifikimin për emërim edhe të kandidatit të fundit, të diplomuar në shkollën e Magjistraturës z. Gentian Jahjoli.

Gjithashtu në vijim të shqyrtimit të thelluar të kriterëve ligjore, pasurisë dhe figurës, të kandidatëve për magjistratë, për tu pranuar në Shkollën e Magjistraturës, Këshilli vendosi kualifikimin për të filluar formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2020-2021, të pesëmbëdhjetë kandidatëve dhe konkretisht z. Artan Çirraga, z. Estjon Venxha, z. Mikel Hysometaj, z. Romeo Merruko, znj. Eglantina Biba, znj. Eranda Cufo, z. Lirim Bulica, znj. Lumturi Zhupa, znj. Nertila Përrallaj, znj. Entela Selmanaj z. Elvis Sulejmani, z. Fjorald Behari, z. Genci Busho, z. Ilirjan Hysa dhe z. Klajdi Tërova